



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
GJIROKASTËR

Nr 348 Prot.

Gjirokastrë, më 15 . 03.2018.

URDHËR

**PËR NGRITJEN DHE FUNKSIONIMIN E SISTEMIT TË TË DHËNAVE PËR
REGJISTRIMIN E STUDENTËVE PËR TË DY CIKLET E STUDIMIT NË
UNIVERSITETIN "EQREM ÇABEJ"**

Bazuar në Raportin e Vlerësimit për Akreditimin Institucional bashkëngjitur Çertifikatës për Akreditim Nr.67 datë 21.09.2017 për Universitetin "Eqrem Cabej" Gjirokastrë,

URDHËROJ

1. Ngritje e sistemit bazik të të dhënave për regjistrimin e studentëve për të dy ciklet e studimit në Universitetin "Eqrem Cabej" Gjirokastrë.
2. Specialisti i zyrës së Këshillimit të Karrierës të krijojë një sistem të dhënash personale për cilindo nga studentët e diplomuar në ciklin e parë "Bachelor".
3. Specialisti e zyrës së ALUMNIT të krijojë një sistem të dhënash personale për cilindo nga studentët e diplomuar në ciklin e dytë "Master Profesional" dhe "Master i Shkencave".
4. Specialistët e Qendres së Shërbimeve Studentore të pajisin me adrese emaili nën logon e UGJ-së çdo student aktual të Universitetit "Eqrem Cabej" Gjirokastrë.
5. Për sa më lartë specialistet e sektorit të shërbimeve studentore ngarkohen për zbatimin e Udhëzimit nr. 5 datë 19.02.2018, Kreu A pika g.
6. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri, zv/Rektori për procesin mësimor, k/degës së zhvillimit kurrikular, karrierës dhe vlerësimit institucional, sektori i Shërbimit Studentor, zyra e IT, zyra e Informacion-Statistikës, K/Sekretaret dhe Sekretarët mësimorë pranë njësive kryesore.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTOR

[Signature]
Prof.dr Bektash MEMA

